

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M


Nr. 25, datë 31.10.2018

**Për miratimin e Rregullores
“Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive
organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”**

Në mbështetje të nenit 43, pika 1, shkronja “m/1”, të nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të Vendimit nr.11, datë 25.05.2017 të Këshillit Drejtues të Agjencisë “Për miratimin e një shtese dhe disa ndryshimeve në Vendimin e KD nr. 19, datë 29.08.2013 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të nenit 12, pika 8, të nenit 15, pika 4, të nenit 20, pika 2 shkronja “ç”, të nenit 24, pika 4, të nenit 25 pika 5, të nenit 64, pika 2, shkronja “ç”, të nenit 71, pika 2 dhe 3, të neneve 73, 76, 77, 78, si dhe 79 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores nr.56, datë 3.10.2017 “Për Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij” të Bankës së Shqipërisë, të Politikës së administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, të miratuar me shkresën nr. 5587/1, datë 10.1.2018 të Bankës së Shqipërisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Drejtues nr.26, datë 16.10.2014 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave””.
3. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Agjencisë për zbatimin e këtij vendimi.



KËSHILLI DREJTUES

4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e rregullore të miratuar me këtë vendim, në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar